



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të

Nr. 45/09

Prishtinë, më 11.03.2009, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: **Gani Koci, Haki Shatri, Kosara Nikolić, Myrvete Pantina, Shkumbin Demaliaj, Xhevdet Neziraj, Riza Smaka, Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani.**

Anëtarët jo të pranishëm të Komisionit: **Müfera Şinik, Besa Gaxherri, Hajdin Abazi.**

Nga stafi mbështetës i Komisionit: **Natasha Prica-Tisma, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.**

Gjithashtu të pranishëm ishin: **Jill Jameison eksperte nga USAID-i, Teki Shala nga NDI, monitorues Zyra e Presidentit, OSCE, KDI.**

Kryesues: Gani Koci, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 25 shkurt 2009**
- 3. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të grupit punues për Projektligjin nr. 03/ L-090 për partneritetet publike – private, koncesionet për sigurinë e infrastrukturës dhe shërbimeve dhe procedurat për dhënien e tyre**
- 4. Shqyrtimi i Ligjit nr. 02/L-97 për Shpronësimin, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi Tregti, Industri, Energjetik, Transport e Telekomunikacion, me amendamente**
- 5. Shqyrtimi Projektligjit nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinore, me amendamente**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.03/L-104 për mbrojtjen nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe siguria nukleare, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për**

Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente

7. Të ndryshme.

Kryesuesi, hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 25 shkurt 2009

Kryesuesi, konstatoi se procesverbali nga mbledhja e kaluar dt.25 shkurt 2009, miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të grupit punues për Projektligjin nr. 03/ L-090 për partneritetet publike – private, koncesionet për sigurinë e infrastrukturës dhe shërbimeve dhe procedurat për dhënien e tyre

Kryesuesi, theksoi se grupi punues i komisionit në bashkëpunim me ekspertin nga Zyra e USAID-it dhe përfaqësuesen e MEF-it, kanë arritur të hartojnë amendamentet përfundimtare, e që janë propozuar për miratim. Njoftoi se është modifikuar amendamenti 5 që ishte kontestues. Në bazë të kësaj është arritur që Kuvendi të ketë rol të rëndësishëm në çështjet e koncesioneve. Roli i tij vjen në shprehej me të drejtën e shqyrtimit të raportit nga Qeveria përmes Ministrisë së MEF-it, i cili raport duhet të përmbaj të dhëna për koncesionet për dymbëdhjetë muajt e kaluar dhe projeksionet për dymbëdhjetë muajt e ardhshëm. Gjithashtu me paragrafin e ri 2.7 është rregulluar çështja e obligimit të raportimit të kryetarëve të komunave para kuvendeve komunale. Si rrjedhojë është mundësuar që Kuvendi të ketë rol të drejtpërdrejt mbikëqyrës në këto procese. Kërkoj nga anëtarët të deklarohen për amendamentet e propozuara.

Shkumbin Demaliaj, propozoi që amendamenti 5 paragrafi 2.6, të modifikohet dhe të shkruhet se Qeveria përmes Ministrisë raporton në Kuvend.

Safete Hadërgjonaj, theksoi se mbështet modifikimin e amendamentit 5, me ndryshimin e të cilit mundësohet arritjen e qëllimeve që duhet të ketë ligji. Në njërin anë krijohen procedura më fleksibile për tërheqjen e investitorëve, ndërsa në anën tjetër procesi i investimeve dhe dhënies së objekteve me koncesion bëhet publik dhe mbikëqyret nga Kuvendi. Në këtë drejtim përmes raportimit në Kuvend, bëhet transparente edhe puna e Qeverisë në këto procese.

Xhevdet Neziraj, theksoi se grupi i tij paralementar e ka përkrahur propozimin e parë dhe jo këtë të fundit, prandaj edhe nuk do të përkrah këtë amendament.

Riza Smaka, u pajtua me amendamentet e fundit të propozuara.

Kosara Nikolić, theksoi se amendamentet e fundit të propozuara nuk i kanë pasur mundësi për t'i diskutuar në grupin saj parlamentar dhe si rezultat nuk do të votoj sot, por se lidhur me ato dhe projektligjin do të votoj në seancën plenare.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se me gjashtë vota Për, një kundër (z. Xhevdet Neziraj) dhe një Abstenim (znj. Kosara Nikolić) Komisioni nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Miratohen amendamentet e propozuara nga grupi punues. Komisioni do të hartoj raportin me amendamente dhe do t'i rekomandoj Kuvendit të miratoj ato së bashku me projektligjin.

4. Shqyrtimi i Ligjit nr. 02/L-97 për Shpronësimin, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi Tregti, Industri, Energjetik, Transport e Telekomunikacion, me amendamente

Kryesuesi, theksoi se në parim ky projektligj dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë kosto shtesë buxhetore. Komisioni duhet të rekomandoj miratimin e tij dhe se paraqitja e implikimeve të mundshme buxhetore duhet të parashihet me rastin e rishikimit të buxhetit.

Safete Hadërgjonaj, si anëtare e komisionit funksional, njoftoi se kemi punuar intensivisht dhe me ndihmën e Zyrës së USAID-it kemi propozuar ndryshimet, me të cilat ligji ka marrë formën e vet më të mirë se më parë. Prandaj kërkoi nga anëtarët të përkrahin atë.

Shkumbin Demaliaj, theksoi se nga amendamentet shifet se është punuar me urgjencë dhe ka mjaftë gabime teknike, të cilat do të duhej të rregulloheshin

Pasi vërejtjeve të bëra, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Ligjit nr. 02/L-97 për Shpronësimin dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
 - II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetik, Transport dhe Telekomunikacion, dhe ka konstatuar se amendamenti nuk përmban implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentin e propozuara.
- ### **5. Shqyrtimi Projektligjit nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinore, me amendamente**

Kryesuesi, theksoi se në amendamentin 7 parashihet krijimi i Agjencisë së Pagesave, funksionimi i së cilës krijon kosto shtesë buxhetore. Prandaj kërkoi të shtyhet miratimi i tij dhe të kërkohet mbajtja e një takimi të përbashkët me komisionin funksional dhe ministrinë sponzoruesi të sqarohen këto dilema për mundësinë e implikimeve që mund të bartë ligji.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural dhe ka konstatuar se amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional mund të përmbajnë implikime shtesë buxhetore.

II. Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon komisionit funksional dhe raportues që të ketë parasysh vlerësimet e komisionit dhe sugjeron që të mbahet një takim i përbashkët në mes Komisionit për Buxhet dhe Financa, Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim e Hapësinor dhe Ministrisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural me qëllim të harmonizimit të qëndrimeve.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.03/L-104 për mbrojtjen nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe siguria nukleare, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente

Kryesuesi, theksoi se edhe me këtë projektligj, përkatësisht amendamentet e propozuara parashihet krijimi i organizatës së re buxhetore brenda organizatës ekzistuese buxhetore, për çka krijon kosto shtesë buxhetore. Prandaj për të sqaruar këto dilema të kërkohet mbajtja e një takimi të përbashkët me komisionin funksional dhe ministrinë sponzoruese.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin nr. 03/L-104 për mbrojtjen nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe siguria nukleare dhe ka konstatuar se amendamentet e propozuara nga komisioni funksional mund të përmbajnë implikime shtesë buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon komisionit funksional dhe raportues që të ketë parasysh vlerësimet e komisionit dhe sugjeron që të mbahet një takim i përbashkët në mes Komisionit për Buxhet dhe Financa, Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim e Hapësinor dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me qëllim të harmonizimit të qëndrimeve.

7. Të ndryshme

Kryesuesi, njoftoi se lidhur me raportin vjetor të TKPK-së, me një shkresë është kërkuar që ai të plotësohet. Gjithashtu njoftoi se kanë arritur disa raporte të agjencioneve të pavarura, si raporti i Zyrës së Auditorit Gjeneral për RTK-në për vitin 2007, raporti vjetor i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2008 dhe raporti vjetor i Organit Shqyrtues të Prokurimit së për vitin 2008. Ndërsa raporti vjetor i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale ka arritur vetëm në versionin shqip dhe është kërkuar të dërgohet edhe versioni në gjuhën serbe. Propozoi që mbledhjen e radhës të shqyrtohen këto raporte. Shqyrtimi i raportit të ZAGJ për RTK-në, do të bëhet në praninë e mediave, që të tregohet publikisht puna joprofesionale që po kryen kjo zyrë.

Naser Osmani, theksoi se në bazë të informatave kjo Zyra e Auditorit Gjeneral ka devijuar në aspektin profesional. Prandaj mbështeti propozimin e kryetarit që në mbledhjen e radhës të diskutohet çështja e funksionimit të punës së kësaj zyre. Përveç kësaj kërkoi që Komisioni të interesohet për miratimin e Ligjit për deputetë.

Safete Hadërgjonaj, duke u ndërlidhur, theksoi se në Zyrën e Auditorit Gjeneral ka joprofessionalizëm në punë, prandaj mbështeti idenë që për problemet rreth funksionimit të kësaj zyre të trajtohen në praninë e mediave.

Shkumbin Demaliaj, theksoi se komisioni të kërkoj nga Zyra e Kryeministrit dërgimin e planprogramit të organizimit të Epopesë së UÇK-së dhe shpenzimet e bëra për këtë organizim.

Kryesuesi, duke iu përgjigjur parafolësit, theksoi se këto çështje do të diskutohen me rastin e shqyrtimit të raportit tre mujor të buxhetit. Ndërsa lidhur me Ligjin për Deputetë, theksoi se ai do të kalojë për shqyrtim në këtë komision.

Mbledhja përfundoi në ora 11:45

Përgatitur nga

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Mbledhja e radhës u caktua më 18 mars 2009, në ora 10:00.

Kryesuesi i Komisionit,

Gani KOCI